



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETITIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2022

Lënda: Përgjigje

Z. Fatmir Isaku

Adresa : Lagjia nr 1, Rruga Taulantia

DURRËS

I nderuar z. Isaku,

Së pari duam t'ju falenderojmë për besimin ndaj punës së institucionit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit.

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion nr. 1332 (tonën) prot. datë 02.08.2022, dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) për informacion, si edhe shqetësimet e ngritura, ju informojmë si më poshtë:

Institucionet kushtetuese, autoritetet publike, në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH”, kanë detyrimin ligjor për t’i kërkuar Autoritetit nëse ekzistojnë informacione në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në kuadër të vlerësimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve, që kanë aplikuar për emërim/ngritje në detyrë apo për kandidatët për zgjedhje.

Nisur nga kërkesat e nenit 29 pika 1 të Ligjit 45/2015, Autoriteti ka detyrimin t’i përgjigjet çdo kërkesë të institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t’u emëruar ose ngritur në detyra.

Autoriteti i referohet në vendimmarrje edhe nenit 2 të ligjit nr.45/2015 në të cilin parashikohet se, “1.Ky ligj zbatohet për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të RPSSH, për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë dhe që lidhen me veprat penale politike të parashikuara në ligjin nr.7514, datë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar pavarësisht nëse është dhënë ose jo një dënim për këto vepra nga organet kompetente të regjimit komunist.

Në çdo rast kur nga verifikimet e kryera ka rezultuar se subjekti i verifikimit ka qenë në detyrën e hetuesit, Autoriteti ka informuar institucionin kërkues sipas nenit 29 pika 2 germa “c” të ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar (figuron në dokumente të ish Sigurimit të Shtetit) për çështjet hetimore të trajtuara nga hetuesit, kur ato bëjnë pjesë në kategorinë e veprave penale

të përkufizuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar,

Në zbatim të dispozitave të mësipërme çdo vepër penale që përfshihet në krimet kundër shtetit përbën vepër penale që futet në fushë veprimin e Autoritetit dhe në këtë kuadër Autoriteti e pasqyron në vendimarrje.

Por roli që ligji i njeh Autoritetit në këtë drejtim është mjaftueshmërsht i drejtpërdrejtë, me vënien e informacionit në dispozicion sipas kërkesës dhe jo kompetenca të shtuara mbi kandidatët/zyrtarët për emërim apo promovim në institucione kushtetuese apo autoritete publike. Në këtë kontekst, vlerësimi i rezultateve të verifikimeve të kandidatëve/zyrtarëve mbetet në diskrecion të institucionit kërkues, për sa i takon kushteve penguese për t’u emëruar/ngritur në detyrë apo për t’u zgjedhur.

Problematikat e hasura gjatë zbatimit të dispozitave të ligjin 45/2015, i ndryshuar, na kanë shtyrë të kërkojmë përmirësime ligjore të cilat do të na ndihmojnë në kryerjen e proceseve të punës me përgjegjësi, integritet dhe transparencë, për ruajtjen e besueshmërisë së institucionit për shoqërinë shqiptare dhe partnerët ndërkombëtarë, për sa kohë që figurat e verifikuara për emërim, ngritje në detyrë apo si të zgjedhur qendrorë e vendorë, luajnë rol të rëndësishëm në vendimarrje dhe politikat publike.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit

L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Në mungesë dhe me Urdhër

Drejtori i Informacionit

Selami Zalli

Konceptoi: L. Cocoli
Datë: 02.08.2022